

VENDIM
Nr.197, datë 16.3.2011

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË

(Ndryshuar me VKM nr. 172, datë 6.3.2012; nr. 447, datë 11.7.2012; nr. 196, datë 6.3.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë, të 9 (nëntë) ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Misioni është planizimi, monitorimi, komandimi dhe kontrolli i aktivitetit operacional të seksioneve dhe njësive të KFOR-it.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni, me venddislokim Prishtinë, Kosovë, është deri më 31 dhjetor 2014. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesit e radhës.

4. Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe transporti strategjik Tiranë-Prishtinë dhe anasjellas është përgjegjësi e palës shqiptare.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shërbim telefonik;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në raste vdekjeje ose sëmundjeje;

ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);

f) ushqim;

g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;

gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacioni.

5/1. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha